

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
 MINISTERIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM
 MINISTRI PËR KOMUNITETET DHE KTHIM
 MINISTARSTVO ZA ZAJEDNICE I POVRAKAK

Njësi Org./Org./Unit: 01

Nr./Titull: 1124 Data/Date: 18.04.2018

Nr. Fajevë/Stranica/No. Pages: 12

PUSHTË KOSOVË/A



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
 ZRAKË Kryeministrit - GRED PREMIJERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER
 SEKTORI I ARKIVES - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR

Njësi Org./Org./Unit: 01 Nr. Prot./Prot. No.: 1059/31

Nr. Fajevë/Stranica/No. Pages: 12 Data/Date: 18.04.2018


Prishtinë / a

Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada – Government
 Ministria për Komunitete dhe Kthim – Ministarstvo za Zajednice i Povratka
 Ministry for Community and Return

Raport i Punës

Janar – Mars 2018

Ministria për Komunitete dhe Kthim



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria për Komunitete dhe Kthim - Ministarstvo za Zajednice i Povratak
Ministry for Community and Return

Data: 15.04.2018

Për: z.Ramush Haradinaj – Kryeministër i Republikës së Kosovës

Nga : Florent Hoxha zëvendësministër i MKK-së

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'FH', is written over the text of the signature.

Lënda : Raport i Punës tremujor Janar – Mars 2018

Vendi: Fushë Kosovë

Ministria për Komunitete dhe Kthim

Përmbajtja:

1.Përmbledhje Ekzekutive.....	4
2.Në vazhdim ju paraqes aktivitetet më të theksuara gjatë muajve Janar – Mars 2018.....	5
3.Aktivitetet e zhvilluara në Janar 2018.....	6
4.Aktivitetet e zhvilluara në Shkurt 2018.....	8
5.Aktivitetet e zhvilluara në Mars 2018.....	9
6. Vizim dhe takime me qytetarë	10
7.Vështirësit	11
8. Synimet.....	11

Ministria për Komunitete dhe Kthim

1.Përmbledhje Ekzekutive

I nderuar Kryeministër z.Haradinaj, kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që si zëvendësministër i MKK-së të prezentoj raportin e punës të tremujorshit të parë 2018.

Në këtë raport janë pasqyruar punët, angazhimet dhe aktivitetet e kryera gjatë kësaj periudhe kohore me rezultatet e arritura si dhe vështirësit që na kanë përcjellurë në punën tonë, njëherit shpresoj që ky raport do ta jetë udhërrëfyes i rezultateve të më tutjeshme.

Angazhimi i ynë në përmbushjen e aktiviteteve tona si zëvendësministër i MKK-së, është në përputhje me programin, misionin dhe vizionin e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, siç janë : zhvillimi i politikave, promovimin dhe zbatimin e ligjeve për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, duke përfshirë të drejtën për t'u kthyer, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjeve, Udhëzimeve Administrative, rregulloreve që rregullojnë fushën për komunitete dhe për persona të zhvendosur në Kosovë. Gjithashtu ,synimi i ynë është në krijimin e kushteve të përshtatshme për kthim të qëndrueshëm për të gjitha komunitetet që bazohet në të drejtat e tyre. Angazhimi im ka qenë me theks të veçant për të vepruar në sigurimin e udhëheqjes në krijimin e besimit, në aktivitetet për dialog dhe pajtimin ndërmjet komuniteteve dhe mbështetjes për zbatimin e këtyre aktiviteteve. Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi kontaktuar, takuar dhe biseduar me institucione e nivelit qendrorë dhe të atyre lokal për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të strategjive afat mesme qeveritare dhe atyre komunale për ndihmë të komuniteteve dhe mbështetjes së tyre dhe avansimin e të drejtave në të gjitha sferat e jëtës bashkohore.

Vizitat që kam bërë, kam takuar disa nga Kryetarët e Komunave veçanarisht në Komunat ku jetojnë komunitetet me një numër të konsiderueshëm.Me ç' rast kemi diskutuar për harmonizimin e përgjegjësisve tona të përbashkëta për të kontribuar në përfshirjen dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, të drejtave të njeriut dhe interesave të të kthyerëve nga rajoni, duke përfshirë fushën e lirisë së lëvizjes, përdorimin e gjuhëve, lirisë së shprehjes, përfaqësimit të drejtë në institucionet arsimore, shëndetësore, punësimit dhe qasjes së barabartë në drejtësi, banim dhe shërbime publike e komunale.

Ministria për Komunitete dhe Kthim

2. Në vazhdim ju paraqes aktivitetet më të theksuara gjatë muajve

Janar – Mars 2018.

Gjatë periudhës raportuese kam vizituar disa komuna të Kosovës, ku banojnë dhe veprojnë pjesëtarë të komuniteteve pakicë.

Kam takuar kryetarët e komunave Ferizaj, Shtëmë, Drenas, Skenderaj, Kaçanik, me të cilët kemi diskutuar tema në mundësi të bashkëpunimit për përmisimin e kushteve të komuniteteve pakicë, ku jam informuar nga kryetarët e komunave dhe zyrtarët e zyrës komunale për komunitet dhe kthim për problemet me të cilat ballafaqohen komunitetet nëpër këto komuna.

3. Aktivitetet e zhvilluara në Janar 2018.

Gjatë muajit Janar me datën 09.01.2018 jam takuar me Nënkryetarin e Komunës së Shtëmës z. Rahman Jakupi, me qëllim që të njihemi me mundësitë e bashkëpunimit mes tyre dhe MKK-së, në projekte të ndryshme.

Në takim u pritëm nga nënkrytari dhe zyrtari i zyrës komunale për komunitet dhe kthim ku u njoftuam për së afër me punën dhe problemet të cilat ata ballafaqohen në vazhdimësi, kemi krijuar ura bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë dhe Komunës, ku u zotuam se do të ndihmojmë në projektet të cilat ata kanë prioritet për qytetarët në veqanti për komunitetet pakic.

Komuna e Shtëmës nuk ka të dhëna zyrtare për regjistrimin e personave të zhvendosur nga viti 1998 deri në vitin 2004. Zyra komunale për komunitete dhe kthim në këtë komunë funksionon nga viti 2011 dhe që atëherë ka filluar bashkëpunimin me gjitha komunitetet pakic, në komunën e Shtëmës pjesa më e madhe e komunitetit janë Ashkali, 1 familje Rome dhe 1 familje Egjiptiane. Nevojat dhe kërkesat në këtë Komunë janë të shumta për komunitete në përgjithësi ndër ato më prioritet janë:

1. Përbërja në punësim.
2. Avancim në sferën e arsimit.
3. Ndërtimi dhe renovimi i shtëpive në nevoj.
4. Investime në infrastrukturë në zona të banuara me komunitete.

Ministria për Komunitete dhe Kthim

Në këtë ditë 09.01.2018 realizuam edhe një takim në Komunën e Ferizajit në këtë takim u takuam me Kryetarin e Komunës si dhe zyrtarë komunal për komunitete dhe kthim, diskutuam për problemet dhe vështirësit të cilat ata përballen.

Në këtë takim në bashkërenduam idetë e bashkëpunimit në mes institucioneve përkatëse si dhe iniciativat që mund të ndërmerren në sfera të ndryshme të qeverisjes. Unë theksoj se institucioni që përfaqësoj ka gatishmërinë për të ndihmuar Komunën e Ferizajit në proceset që janë pjesë e kompetencës së saj. Ndërkaq duke falenderuar për mbështetjen e ofruar, kryetari Aliu vuri theksin tek toleranca ndër etnike që është ndër virtytet kryesore të qytetarëve të Ferizajit, që e bënë më të lehtë realizimin e projekteve. Edhe në këtë Komunë nuk ka të dhëna zyrtare për regjistrimin e të zhvendosurve nga viti 1998-2004. Nevoja dhe kërkesat e komunës së Ferizajit për përmisimin dhe lehtësimin e jetës së qytetarëve janë:

- 1.Renovimi i shtëpiave.
- 2.Investime në infrastrukturë.
- 3.Investime në kabinete shkollore etj.



Foto e realizuar gjatë takimit në Komunën e Drenasit.

Gjatë muajit Janar në vazhden e takimeve nëpër komuna me datën 10.01.2018 realizuam një takim pune në Komunën e Drenasit. Në takim na priti nënkryetari dhe zyrtarja komunale për komunitete dhe kthim në këtë komunë, diskutuam për mundësitë bugetore të ministrisë dhe ndërtimin e bashkëpunimit institucional, ne si ministri do ti përkrahim projektet të cilat kanë planifikuar ti realizojnë për përmisimin dhe krijimin e lehtësimit për qytetarët.

U diskutua edhe për përfshirje më të gjerë të komuniteteve pakicë në arsimim dhe fusha të tjera në mënyrë të integritimit dhe socializimit me të gjitha komunitetet.

Në komunën e Drenasit nuk ka të dhëna zyrtare se sa janë të zhvendosur.

Kërkesat e Komunës së Drenasit janë:

- 1.Ndërtimi i gjashtë shtëpiave për familje minoritete.
- 2.Rregullimi i shtratit të lumit “Drenica”
- 3.Ndërtimi i Tombinave- Urave në disa fshatra të komunës së Drenasit
- 4.Ndërtimi dhe Asfaltimi i Rrugës Tërdec-Vuqak



Foto e realizuar gjatë takimit në Komunën e Drenasit.

Ministria për Komunitete dhe Kthim

4. Aktivitetet e zhvilluara në Shkurt 2018.

Me datën 23.02.2018 kam vizituar Komunën e Skenderajit ku jam takuar me Kryetarin, Bekim Jasharin dhe zyrtarët komunal për komunitet dhe kthim.

Gjatë këtij takimi, u diskutua për funksionimin dhe koordinimin e zyrës për komunitete dhe kthim me qytetarët e Komunës së Skenderajit, për trajtimin e personave të zhvendosur si dhe për projekte që janë në kuadër të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

Kërkesat e komunës së Skenderajit janë:

1. Material ndërtimorë për 11 familje në nevojë.

2. Ndërtimi i një qendre Kulturore-Sportive në Runik ku do të shërbej të gjitha fëmijët e rritur që jetojnë në këtë zonë.

Kërkuan investime kapitale në të gjithë infrastrukturën, ku ka mundësi MKK-ja që të investojë.



Foto e realizuar gjatë takimit.

5. Aktivitetet e zhvilluara në Mars 2018.

Gjatë muajit Mars kam vizituar komunën e Kaçanikut ku jam takuar me kryetarin e kësaj komune z. Besim Ilazi dhe zyrtarët e zyrës komunale për komunitete dhe kthim bashkëbiseduam për të filluar bashkëpunimin ndërmjet Komunës dhe Ministrisë. U njoftuam me problemet e kësaj Komune u zotua se do të përkrahim projektet të cilat do të ju mundësojnë lehtësira të gjithë qytetarëve në të gjitha fushat, infrastrukturë, në zhvillim ekonomik dhe avancimin e komuniteteve pakic, avancimin e tyre në fushën e arsimit. Nga viti 1999 në këtë komunë nuk është kthyer as një qytetarë nga komuniteti Serb.

Ndër prioritetet kryesore në këtë komunë janë:

1. Investime në infrastrukturë
2. Ndërtim dhe renovim të shtëpive.




Foto e realizuar gjat takimit.

Ministria për Komunitete dhe Kthim

Kemi realizuar edhe disa takime zyrtare me zëvendësministrin e shëndetësisë Dr. Rustem Musa biseduam për problemet dhe të metat në kujdesin shëndetësor, në veçanti për shërbimet shëndetësore edhe në komunën e Lipjanit, me ç'rast Ministri i Shëndetësisë vizitoi për së afërmi QKMF- Lipjan dhe dhuroi një Autoambulancë për komunitetin në Janjevë.



Foto e realizuar gjatë takimit

6. Vizita dhe takime me qytetarë

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë adresuar disa kërkesa nga familjet Shqiptare, Rome, Ashkali dhe Egjiptas në adresë të MKK-së, ku kanë kërkuar ndihmë në ndërtimorë (Renovim) dhe ndërtim të shtëpiave. Ne kemi vizituar disa nga ata për të shikuar nga afër gjendjen e tyre, dhe kemi sygjeruar në plotësimin dokumentacionit sipas udhëzimit administrativ dhe rregullorëve të MKK-së.

Jemi takuar me disa qytetarë të zhvendosur nga Mitrovicë e Veriut, gjegjësisht i Vitakut ku qytetarët e kësaj ane kanë kërkuar nga institucioni i MKK-së që të ndërtim dhe renovimin e shtëpiave të tyre, në mënyrë që të jetojnë në këtë zonë.

Angazhimi i ynë është dhe do të mbetet në krijimin e politikave të institucionit të MKK-së që qëndrueshëm për të gjithë komunitetet në vend.

Brenda kësaj periudhe kemi pasur disa takime të ndryshme me organizata jo qeveritare të qytetarë ku janë drejtuar me kërkesa në zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga MKK-së.

Ministria për Komunitete dhe Kthim

Kemi marrë pjesë në takime të ndryshme në bazë të ftesës nga institucionet e Republikës së Kosovës.

7. Vështirësitë

Brenda kësaj periudhe raportuese kemi pasur edhe vështirësi në realizimin e objektivave tona në mungesë të delegimit apo autorizimit të kompetencave nga Ministri i MKK-së në disa prej programeve që janë duke u zhvilluar në Ministrinë. Për këtë kam kërkuar edhe me shkrim më datën 12.01.2018.

Nuk kam marrë asnjë përgjigje nga Ministri i MKK-së deri më tani. Për këtë ju kam njoftuar në email zyrtar i nderuar z. Kryeminister.

8. Synimet.

- ❖ Të shpohën aktivitetet që burojnë nga detyrat dhe përgjegjësit e përcaktuara me aktet ligjore dhe aktet tjera normative.
- ❖ Qasje dhe shtim i aktiviteteve të vazhdueshme për realizimin e politikës zhvillimore të MKK-së.
- ❖ Intensifikimi i aktiviteteve në realizimin e detyrave të institucionit të parapara me planin e punës nga Qeveria sipas standarteve të kërkuara.
- ❖ Ngritja e përkushtimit brenda departamenteve për plotësimin e infrastruktures ligjore.
- ❖ Përfundimi me institucione dhe Agjencione të tjera për përfitimin e donacioneve për projekte të ndryshme për realizimin e objektivave të MKK-së.
- ❖ Intensifikimi i aktiviteteve sipas kompetencave të punës në përputhje me rregullativen në fuqi në realizimin e planifikimeve brenda institucionit të MKK-së.
- ❖ Realizimi i prioriteteve të përcaktuara me Strategjinë nga niveli Qeveritar për persona të zhvendosur dhe integrimin e komuniteteve në përgjithësi.

Me respekt!

Zv.Ministri Daut Hoxha





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria për Komunitete dhe Kthim -
Ministarstvo za Zajednice i Povratak - Ministry for Community and Return

DATE/A:	12.01.2018
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Z. Dalibor Jevtic, Zëvendëskryeministër/Ministër i MKK-së
CC:	Z. Ramush Haradinaj Kryeministër, Z. Vllam Hoxhaj Zëvendëskryeministër
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Florent Hoxha, Zëvendësministër i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim
SUBJEKTI/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkese për delegimin e punëve

I nderuari Zëvendëskryeministër/Ministër i MKK-së.

Duke u bazuar në Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011) neni 13 dhe po ashtu ju referencimit të fundit që patëm me Kryeministrin z. Ramush Haradinaj, kërkojë nga ju të më jepni autorizimin për kryerjen e disa punëve që rrjedhin nga plani i punës së Qeverisë për vitin 2018 konkrètement të MKK-së.

Andaj lidhur me atë çfarë u tha me lartë kërkoj autorizimin tuaj në punët që lidhen me si në vijim: Pjesëmarrje në hartimin e Strategjisë për Komunitete dhe Kthim, koncepti dokumentin për nxjerrjen e Ligjit për Personat e Zhvendosur, koncepti dokumenti për kryerjen dhe aktivitetet e MKK-se, si dhe lejimin apo qasjen në dhënien e kontributit tim për shërbime në ndonjërin nga nën-grupet tematike punuese të Iniciativës Ndërinstitucionale për Personat e Zhvendosur (apo Procesi i Shkupit)

Duke shpresuar që kërkesa ime do të hasë në mirëkuptimin tuaj ju falënderojmë për vëmendjen Tuaj.

Me respekt,
Florent Hoxha